



STATUTI

"Organizatës Balli Kombëtar Demokrat"

Kreu I

Paraqitja

Neni 1

"Organizata Balli Kombëtar Demokrat" është pasardhësja e të gjitha përpjekjeve të popullit shqiptar për liri, demokraci dhe bashkim kombëtar. Ajo është subjekt politik që bashkon shqiptarët brenda dhe jashtë vendit.

Veprimtaria politike dhe organizative të Organizatës Balli Kombëtar Demokrat ushtrohet në përputhje me Statutin dhe Programin, Kushtetutën dhe dispozitat valide ligjore në Republikën e Kosovës .

Kreu II

Detyrat e Organizatës Balli Kombëtar Demokrat

Neni 2

Organizata Balli Kombëtar Demokrat i ngarkon vetes këto detyra: Krijon kushte për bashkimit shpirtëror dhe politik të popullit shqiptar, për lartësimin ekonomik dhe kulturor të tij dhe për barazimin e të drejtave të njeriut. Ajo kërkon të forcojë ndërgjegjen kombëtare të shqiptarëve dhe të hedhë bazat e një morali politik kombëtar. Ajo ndihmon për ndriçimin e opinionit shoqëror mbarëkombëtar rreth problemeve të ndryshme politike, ekonomike dhe kulturore. Kërkon të ngrijë lart shkallën e zhvillimit ekonomik, kulturor dhe shkencor të popullit shqiptar. Ndihmon për forcimin dhe përsosmërinë e bazës ligjore të shtetit,

Kreu II

Emri, Sigla, Selia, Vula, Emblema

Neni 3

Emri i partisë është : "Organizata Balli Kombëtar Demokrat" Sigla është OBKD. Emblema është në flamurin e Organizatës.

Neni 4

Selia qendrore e "Organizates Balli Kombetar Demokrat" ndodhet ne Prishtinë.

Neni 5

**"Organizata Balli Kombëtar Demokrat" ka vulën e vet, e cila e ka formën e katrorit .
ne qender të vulës është vendosur OBKD.**

Neni 6

**"Organizata Balli Kombëtar Demokrat" ka emblemën dhe flamurin e sajë.Emblema e OBKD-s paraqet
nje katrorë në mesin e te cilit është vendosur OBKD.**

Kreu IV

ANËTARËSIMI NË OBKD

PRANIMI NË OBKD

Neni 7

**Anëtarët e OBKD mund te jen te gjith qytetaret me banim brenda ose jashtë atdheut, që pranojnë
Programin dhe Statutin dhe që marrin pjesë në punën e një strukture organizative të saj.**

Neni 8

**Pranimi i anëtarëve në parti bëhet në bazë të kërkesës me shkrim të secilit dhe pas votimit të hapur ose
të fshehtë të anëtarëve të sekcionit . Moshë e pranimit duhet te jete mbi 18 vjec, pavarsisht nga feja,
gjendja shoqërore ose gjinia.**

Neni 9

Anëtarët e OBKD-së kanë dokument të njëjtë anëtarësie kudo që ata ndodhen.

Neni 10

**Personat e pranuar në OBKD paguajnë kuotat(antarsinë)vjetore. Ata anëtarë që janë të papunë dhe
nuk kanë të ardhura financiare të tjera çlirohen nga pagesa.**

Neni 11

Nuk pranohen të hyjnë në OBKD:

- a) **ata që përhapin pikëpamje dhe ide antikushtetuese dhe antikombëtare.**
- b) **ish-anëtarët e shoqatave raciste, komuniste, fashiste dhe antikombëtare si dhe ish-agjent të sigurimit të shteteve komuniste.**
- c) **individë me sjellje jo të mira shoqërore e morale dhe të dënuarit ordiner deri rehabilitimin ligjor të tyre.**
- d) **ata që bëjnë pjesë në një parti tjetër.**

TË DREJTAT E ANËTARËVE TË OBKD

Neni 12

Anëtari i OBKD-së ka këto të drejta:

Të marrë pjesë lirisht në diskutime, në mbledhjet, ose në shtypin e Organizatës, për të shfaqur mendimin e tij, të zgjedhë dhe të zgjedhet në të gjitha organet drejtuese dhe të administratës. Të marrë pjesë në të gjitha veprimtaritë e organizuara nga OBKD-ja

Të propozojë dhe të propozohet kandidat përfaqësues i Organizatës në organet e pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv.

Të njihet me veprimtarinë e organeve drejtuese dhe të përfaqësuesve të Organizatës në organet e pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv.

Të bëjë propozime në çdo organ të Organizatës për problemet që lidhen me veprimtaritë e saj.

T'i drejtohet Organizatës për të mbrojtur të drejtat e tij të ligjshme. Të jetë i pranishëm në mbledhjet e Organizatës në të gjitha nivelet, kur merret ndonjë vendim që ka të bëjë personalisht me të. Të merret në mbrojtje nga Organizata kur çënohet gjatë ushtrimit të aktivitetit politik ose për shkak të bindjeve politike.

Të informohet rregullisht në mbledhjet partiake dhe nga shtypi mbi vendimet dhe veprimtarinë e organeve të Organizatës.

Të largohet nga Organizata me dëshirën e tij, duke e deklaruar këtë me shkrim. Të gjithë anëtarët e OBKD-së janë të barabartë në raport me partinë, pavarësisht nga funksionet që kanë brenda saj dhe gjendjes ekonomike.

DETYRAT E ANËTARËVE TË OBKD-SË

Neni 13

Anëtari i OBKD-së ka për detyrë:

Të mbrojë me ndërgjegje programin dhe statutin, si dhe të zbatojë vendimet e OBKD-së .

Të forcojë autoritetin , të punojë aktivisht për t'u dhënë jetë qëllimeve të Organizatës dhe për të realizuar vendimet e saj.

Të marrë pjesë aktivisht në veprimtarinë e degës ku bën pjesë.

Të respektojë ligjet e Republikës së Kosovës, dhe juridiksionit përkatës ku ai jeton dhe vepron.

HUMBJA E ANËTARËSISË

Neni 14

Anëtari i OBKD-së mund të dalë nga Organizata me vullnetin e tij në çdo kohë. Për këtë njofton me shkrim sekcionin ku bën pjesë dhe dorëzon dokumentin e anëtarësisë së Organizatës.

Kur anëtari i OBKD-së ka arsye shëndetësore ose arsye pune, atëherë për shkak të mos pjesëmarrjes në jetën politike të Organizatës mund të bëhet ndërprerja e anëtarësimit në mënyrë të përkohshme.

Ndërprerja e anëtarësisë bëhet kur anëtari i OBKD-së punësohet në sektorë ku pjesëmarrja në parti ndalohet me ligj.

Antari mundë të përjashtohet nga Organizata kur shkelen rëndë vendimet e forumeve të saj,

- **Kur ndërpret aktivitetin politik mbi 6 muaj.**
- **Kur cënohen detyrimet e caktuara në këtë Statut.**
- **Kur i shkakton dëm funksionimit të Organizatës.**
- **Kur deklarohet fajtor me vendim të formës së prerë të një gjykate për veprimtari kriminale.**
- **Kur veprimtaria e tij nuk justifikon qënien në parti.**
- **Sipas shkallës së përgjegjësisë merren këto masa:**
 - a) **Anëtarit të Organizatës i tërhiqet vërejtja.**
 - b) **Shkarkohet nga postet që ka përfituar nga qenia në parti.**
 - c) **Përjashtohet nga Organizata.**

- ***Vendimi për masat e mësipërme merret në seksion të Organizatës ku ai bën pjesë.***

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë posa ai të aprovet nga kryesia e OBKD-së për degën ose nëndegën përkatëse.

Anëtari i përjashtuar ka të drejtën e apelit brenda 10 ditëve deri në organin më të lartë, i cili ka të drejtën e ndryshimit ose të anulimit të masës ndëshkimore.

KREU V

STRUKTURA ORGANIZATIVE E OBKD-së

Skema organizative e Organizatës brenda territorit të Republikës së Kosovës ngrihet mbi bazën e ndarjes administrative shtetërore. Ndërsa jashtë këtij territori ngrihet në përputhje me kushtet e veçoritë e vendit ku ekzistojnë elementët e OBKD-së.

SEKSIONI I ORGANIZATËS

Neni 15

Njësia bazë e OBKD-së është seksioni i cili krijohet nga 5 deri në 20 anëtarë. Seksioni i Organizatës në mbledhjen e parë zgjedhë kryetarin, zv/kryetarin dhe sekretarin. Seksioni ngrihet sipas vendbanimit në bazë fshati, lagjeje etj.

Neni 16

Seksioni i OBKD, përpunon, zbërthen dhe zbaton politikën e OBKD, mban lidhje me simpatizantët, zgjeron ndikimin e OBKD-së në shtresat e ndryshme të popullsisë, mban lidhje me shoqatat dhe forcat politike në zonën ku vepron, në përputhje me dokumentat bazë të OBKD, punon për zgjerimin e radhëve të Organizatës, respekton mendimin e çdo individi brenda dhe jashtë seksionit, si dhe mban qëndrimin e secilit që shkel normat dhe vendimet e Organizatës.

Neni 17

Organi më i lartë i seksionit është mbledhja e seksionit që mbahet jo më pak se 1 herë në muaj. Anëtarët që bëjnë pjesë në seksion kanë votë të barabartë, ndërsa mbledhja e seksionit është sovrane në problemet e aktivitetit dhe të drejtimit. Drejtuesi i seksionit (kryetari) zgjidhet me vote të fshehtë nga anëtarët e seksionit, me shumicë vote një here në tre vjet.

NËNDEGA E ORGANIZATËS

Neni 18

Nëndega krijohet me vendim të këshillit të degës dhe me miratim të Kryesisë të Organizatës. Nëndega krijohet në bazë qyteti, mbi çdo komunë kur qyteti është i vogël ose mbi bazë rajoni kur qyteti është i madh.

Neni 19

Nëndega funksionon në përputhje me statutin, programin dhe vendimet e kryesisë së OBKD-së, Organi më i lartë i saj është mbledhja e nëndegës, ku zgjedh kryesinë dhe kryetarin, zv/kryetarin, sekretarin e saj.

DEGA E ORGANIZATËS

Neni 20

Dega është përfaqësuese e Organizatës. Ajo vendos për qëndrimin e Organizatës në lidhje me problemet lokale. Qëndrimi i saj duhet të jetë në përputhje me Statutin, Programin ose Platformën e Organizatës.

KONFERENCA E DEGËS SË ORGANIZATËS

Neni 21

Konferenca e degës së Organizatës është organi më i lartë në nivelin lokal, e cila mbledhet një herë në 3 vjet.

Konferenca e degës zgjedh kryesinë: kryetarin, zv/kryetarin dhe sekretarin e degës. Numri i madh i anëtarëve të kryesisë dhe rregullorja e zgjedhjeve caktohet nga kryesia e Organizatës.

Kryetari i rinisë së OBKD-së dhe kryetarja e gruas së OBKD-së për degën bëhen drejtpërdrejtë anëtarë të kryesisë së degës.

Konferenca zgjedh delegatët për Kongresin e Organizatës si dhe anëtarët e Këshillit Kombëtar të saj.

Delegatët në konferencën e Organizatës së degës janë, ata që zgjidhen si të tillë nga sekcionet, koordinatorët e degëve, asamblistët, kryetarët e komunave, këshilltarët e çdo niveli si dhe deputetët në parlament kur këto janë anëtarë të OBKD-së, anëtarë të Këshillit Kombëtar si dhe anëtarët e Komisionit të Kontrollit të Respektimit të Statutit.

KRYESIA E DEGËS

Neni 22

Kryesia e degës së Organizatës përcakton ndarjen e punëve e të përgjegjësive për kryetarin, zv/kryetarin, sekretarin si dhe anëtarë të tjerë të kryesisë. Kryetari, zv/kryetari dhe sekretari ndjekin zbatimin e përditshëm të detyrave. Për organizimin përcaktohet një rregullore e brendëshme e punëve në kryesi. Kryesia organizon dhe miraton ngritjen e strukturave organizative të OBKD-së në degë. Ajo përgjigjet për plotësimin e detyrave të caktuara nga organet drejtuese qendrore. Bashkëpunon me forcat e tjera politike si dhe raporton për punën e bërë për konferencën e Organizatës në nivel të degës. Përgjigjet për ruajtjen dhe administrimin e materialeve dhe dokumenteve të Organizatës. Kryetari i OBKD-së në degë nuk zgjidhet më shumë se dy herë radhazi.

KOORDINATORËT E DEGËVE

Neni 23

Kryesia e Organizatës me propozimin e kryetarit të OBKD-Së cakton koordinatorët e Organizatës pranë degëve. Koordinatori promovon dhe kontrollon aktivitetin e degëve duke e garantuar zbatimin e vijës së Organizatës, duke referuar në organet apriorë drejtuese. Me propozimin e tij/saj dhe me miratimin e kryesisë së Organizatës vendoset mbledhja e Konferencës së jashtëzakonshme të degës, kur ka probleme të mprehta që kërkojnë zgjidhje.

ORGANET DREJTUESE QËNRORE TË OBKD-së

Neni 24

Janë Kongresi, Këshilli Kombëtar, Aktivi Kombëtar, Kryesia dhe Komisioni Qëndror i Kontrollit dhe i Respektimit të Statutit.

KONGRESI

Neni 25

Kongresi është organi më i lartë politik i Organizatës, i cili përfaqëson të gjithë anëtarët e OBKD-së dhe shpreh vullnetin kolektiv të tyre.

Neni 26

Vendimi për thirrjen e tij për afatet e mbajtjes, për mënyrën e organizimit, për rregullat e përfaqësimit, për mënyrën e zgjedhjes së delegatëve merret nga Këshilli Kombëtar jo më vonë se 3 muaj përpara mbajtjes së Kongresit.

Kongresi diskuton dhe vendos vijën politike të OBKD-së. Ai zgjedh kryetarin e Organizatës dhe ratifikon anëtarët e Këshillit Kombëtar, atë të Komisionit Qëndror të Kontrollit dhe Respektimit të Statutit. Miraton Statutin e Organizatës, Programin politik, ekonomik dhe shoqëror. Ka të drejtën e iniciativës ligjore. Miraton raporte për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar dhe Respektimit të Statutit.

Neni 27

Kongresi i jashtëzakonshëm i OBKD-së, mund të thirret brenda një muaji nga marrja e vendimit me kërkesën e 50% të degëve të Organizatës.

1. Komisioni i përgatitjes së Kongresit kryesohet nga kryetari i Organizatës ose nga zv/kryetari i Organizatës. (me rekomandim të kryetarit),

- Ky komision propozohet nga kryesia dhe ratifikohet në Këshilli Kombëtar i OBKD-së, që përbëhet jo më pak se 11 (njëmbëdhjetë) persona

- *Detyra e Komisionit është të mbulojë anën organizative të Kongresit të Organizatës por jo të vendimmarrjes.*

- *Koha e ngritjes së këtij komisioni është jo më vonë se dy muaj nga dita e Kongresit.*

Neni 28

Vendimet në Kongresin e Organizatës për zgjedhjen e organeve drejtuese merren me votim të fshehtë, ndërsa probleme të tjera merren me votim të hapur, me shumicën e votave të delegatëve të tjerë të pranishëm në votim.

Neni 29

Kongresi drejtohet nga një presidium ku bën pjesë kryesia e OBKD-së. Puna e Kongresit si dhe vendimet e dala prej tij quhen të ligjshme nëse në Kongres marrin pjesë më shumë se gjysma e delegatëve 50+1%.

Neni 30

Delegat me te drejt vote quhen: Delegatët e zgjedhur nga konferencat e degëve te OBKD-së, deputetët, ministrat, kryetarët e komunave, delegatët e rinisë së OBKD-së dhe kryetarja e gruas së OBKD-së, dhe delegatët e OBKD-së në Mërgatë.

KËSHILLI KOMBËTAR I OBKD

Neni 31

Përbëhet nga përfaqësimi i degëve të Organizatës. Këtë përfaqësim proporcional e përcakton kryesia e Organizatës me vendim të veçantë. Brenda këtij numri përfshihen të gjithë kryetarët e Organizatës së degëve. Kryetarët e Organizatës se degëve janë patjetër anëtarë të Këshillit Kombëtar dhe çdo zëvendësim i tyre si kryetar i degëve shoqërohet me emërimin direkt edhe si anëtar i Këshillit Kombëtar. Ndërsa vendet që krijohen vakant në Këshillin Kombëtar, si rezultat i zhvillimeve të brendshme të Organizatës, si rezultat i largimeve, përjashtimeve, etj., zëvendësohen sipas propozimeve të kryesisë të Organizatës në degë me ratifikim nga Këshilli Kombëtar. Anëtarë të Këshillit Kombëtar janë: Kryesia, Kryetari i rinisë, Kryetarja e gruas së OBKD-së, dhe deputetët, ministrat, kryetarët e komunave, që janë anëtarë të OBKD-së, si dhe përfaqësues nga mërgata, sipas një proporcionali të caktuar me vendim të kryesisë së Organizatës. Veprimtaria e Këshillit Kombëtar drejtohet nga kryetari dhe kryesia e Organizatës.

Neni 32

Me propozimin e kryetarit të Organizatës me votim të fshehtë ose të hapur dhe me shumicë votash, Këshilli Kombëtar në mbledhjen e tij të parë zgjedh zv/kryetarin, sekretarin e përgjithshëm të Organizatës ndërmjet 1(një) ose më shumë kandidaturash si edhe anëtarët e tjerë të kryesisë.

Për shkelje të rënda të Statutit te Organizatës, për qëndrimet që bien ndesh me vijën politike ose me programin e Organizatës, për sjellje të pahijshme morale shoqërore me propozim të më shumë se 50%

të Këshillit Kombëtar ka të drejtë të kërkojë votëbesim për zv/kryetarin dhe sekretarin e përgjithshëm. Votimi për shkarkimin e tyre bëhet i fshehtë, me pjesëmarrjen në votim të më shumë se gjysmës së anëtarëve të KK me shumicë votash dhe është i paapelueshëm.

Neni 33

Këshilli Kombëtar i OBKD-së përcakton rrugët e realizimit të vendimeve të Kongresit të Organizatës dhe kontrollon zbatimin e programit dhe të Statutit të Organizatës. Shqyrton çdo vit raportet për veprimtarinë e kryesisë së Organizatës.

Koordinon veprimtarinë e degëve të Organizatës. Emëron koordinatorët e degëve të Organizatës, të cilët realizojnë raportet e degëve me qendrën sipas një ndarjeje rajonale që caktohet nga kryesia e Organizatës.

Krijon komisionet e përhershme, përbërë nga anëtarët e Këshillit Kombëtar si dhe nga përfaqësuesit e opinionit publik për të ndihmuar arritjen e qëllimit që ka marrë përsipër Organizata. Miraton buxhetin vjetor të Organizatës, planet dhe veprimtaritë kryesore, si dhe programet shumëvjeçare. Shqyrton dhe vlerëson aktivitetin e kryesisë së Organizatës. Vlerëson punën e deputetëve, ministrave, funksionarëve të lartë të shtetit, të pushtetit lokal dhe të funksionarëve që janë kandiduar nga Organizata.

KRYETARI I ORGANIZATËS

Neni 34

Kryetari i OBKD-së me propozim të shumicës së delegatëve zgjidhet direkt me votim të fshehtë në Kongresin e Organizatës. Kryetar mund të zgjidhet ai person që ka fituar mbi 50% të votave të pjesëmarrësve në Kongres(me mandat).

- Ka të drejtën e kandidimit për kryetar partie çdo anëtar i Këshillit Kombëtarë që ka më shumë se një mandat si anëtar i Këshillit Kombëtar të Organizatës dhe me kontribute të spikatura.

- Kandidaturat për kryetar partie ratifikohen në Këshillit Kombëtarë të Organizatës me propozimin e kryesisë së Organizatës.

Neni 35

Kryetari i Organizatës ka të drejtën e propozimit të anëtarëve të kryesisë së Organizatës, dhe të strukturave drejtuese të Organizatës në Këshillin Kombëtar mbasi fiton mandatin në Kongres.

Neni 36

Kryetari i Organizatës ka të drejtën që me mbështetjen e 1/3 së anëtarëve të Këshillit Kombëtar, të thërrasë Kongresin e jashtëzakonshëm të Organizatës.

Neni 37

Kryetari i Organizatës përfaqëson dhe drejton aksionet politiko-organizative në përputhje me vijën e Kongresit dhe vendimet e Këshillit Kombëtar. Emëron dhe shkarkon çdo punonjës në qendër dhe në bazë, të cilët nuk janë zgjedhur nga forumet e Organizatës.

Konsulton departamentet, zyrat dhe organizon aktivitetin e tyre në këshillim me kryesinë e Organizatës. Angazhon anëtarët e kryesisë dhe funksionarë të tjerë të aparatit të Organizatës me punën organizative.

Cakton delegacionet për kontaktet me jashtë dhe ndërpartiake brenda vendit.

ZV/KRYETARI I ORGANIZATËS

Neni 38

Zv/Kryetari i Organizatës propozohet nga kryetari i Organizatës dhe miratohet me shumicë votash në mbledhjen e Këshillit Kombëtarë të Organizatës kur pjesëmarrja është 50+1%.

Neni 39

Zv/Kryetari i Organizatës zëvendëson automatikisht kryetarin me të drejta të plota statutore kur kryetari i Organizatës nuk ndodhet në detyrë. Për raste të jashtëzakonshme zv/kryetari zvendëson kryetarin deri në kongresin pasardhës. Ai drejton politikat dhe programet ekonomike në parti në përputhje me vijën politike të Organizatës si dhe probleme të tjera të organizimit.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Neni 40

Sekretari i përgjithshëm propozohet nga kryetari dhe miratohet në Këshillin Kombëtar me shumicë votash kur pjesëmarrja është 50+1%.

Neni 41

Sekretari i përgjithshëm ndjek zhvillimet politike të vendit, drejton propagandën e Organizatës në përputhje me programin dhe statutin e saj.

KRYESIA E OBKD

Neni 42

Organi ekzekutiv i Këshillit Kombëtar është kryesia, e cila në periudhën mes dy mbledhjeve të Këshillit Kombëtar është organ drejtues. Kryesia e Organizatës mblidhet jo më pak se dy herë në muaj. Drejton zbatimin e vendimeve të Kongresit, të mbledhjeve të Këshillit Kombëtar, të punës të seksioneve dhe të komisioneve të përhershme.

Drejton punën e përditshme të Organizatës dhe veprimtarinë e seksioneve ose të këshillave të krijuara pranë kryesisë. Harton projektet e buxheteve vjetore të Organizatës, projektet e planeve të veprimtarisë kryesore dhe programeve të tyre.

Miraton rregulloret e seksioneve, të komisionerve të përhershëm dhe të grupeve të krijuara pranë Këshillit Kombëtar. Përgatit lëndët për diskutim në mbledhjen e Këshillit Kombëtar dhe në veprimet e tjera kombëtare të Organizatës. Merr vendim për shpenzimin e mjeteve financiare, si dhe për sigurimin e veprimeve organizative të Organizatës.

Në emër të OBKD-së përmbyll aktet, bën marrëveshjet, jep garancitë, hap dhe mbyll llogaritë përkatëse të Bankës së Shtetit dhe administron pasurinë e Organizatës brenda kufijve që cakton ligji dhe në lidhje me Statutin e Organizatës.

Vendimet e saja janë të ligjshme kur në votim (të hapur ose të fshehtë) marrin pjesë më shumë se 2/3 e anëtarëve të kryesisë.

Neni 43

Kryesia vendos për bashkëpunim me partitë, shoqatat dhe forumet për çështje të ndryshme. Vetëm për problemet që kanë të bëjnë me vijën politike thërret Këshillin Kombëtar për të vendosur. Harton taktikat elektorale, programet elektorale si dhe listën e kandidaturave.

Miraton ose shkarkon kryeredaktorin si dhe kolegjiunin e redaksisë. Merr vendime për çështje të rëndësishme politike mbi qëndrime ose deklarime të pozicionit të saj, në mbështetje të vendimeve të Këshillit Kombëtar.

Neni 44

Kryesia në mbledhjen e saj të parë me propozim të kryetarit të Organizatës, me shumicë votash miraton sekretarët e Organizatës, atë organizativ, atë të marrëdhënieve publike dhe atë të problemeve ekonomike. Me propozim të kryesisë ose të 1/3 të anëtarëve të saj, me shumicë votash, me votim të fshehtë, me pjesëmarrjen e më shumë se 2/3 e anëtarve, kryesia mund të shkarkojë secilin prej sekretarve të Organizatës.

KRYESIA E ORGANIZATËS

Neni 45

Përbëhet nga:

- **Kryetari**
- **Zv/kryetari**
- **Sekretari i përgjithshëm**
- **Sekretarët (organizativ, marrëdhënie publike, marrëdhënieve ndërkombëtare dhe ekonomike)**

- *Anëtarët e kryesisë (të gjitha degët kanë përfaqësi kryetarët e degëve të OBKD-së)*
- *Kjo kryesi është organi ekzekutiv që punon dhe mban përgjegjësi për zbatimin e vijës politike të OBKD-së të miratuar nga Kongresi dhe nga KK.*

KOMISIONI QËNDROR I KONTROLLIT DHE RESPEKTIMIT TË STATUTIT

Neni 46

Komisioni qëndror i kontrollit dhe respektimit të statutit zgjidhet nga Këshilli Kombëtar i Organizatës me propozimin e një ose dy kandidaturave me votim të fshehtë.

Ky komision në mbledhjen e tij të parë zgjedh kryetarin, sekretarin dhe 3 anëtarë. Pjestarët e këtij komisioni nuk bëjnë pjesë në kryesi të OBKD-së. Kontrollon zbatimin e Statutit të Organizatës, të vendimeve të Kongresit, të Këshillit Kombëtar, të kryesisë si dhe të dokumentave bazë të Organizatës. Kontrollon diskutimin e kërkesave, deklaratave, ankesave që u drejtohen organeve qëndrore.

Kontrollon veprimtarinë ekonomiko-financiare dhe zbatimin e drejtë të buxhetit të Organizatës.

Neni 47

Komisioni qëndror i kontrollit dhe respektimit të statutit është organi qëndror disiplinor i OBKD-së

KOMISIONI I STATUTIT

Neni 48

Komisioni i Statutit zgjidhet nga Këshilli Kombëtar i Organizatës dhe përbehet nga kryetari i tij, sekretari dhe 3 anëtarë. Komisioni i Statutit interpreton Statutin dhe aktet e tjera normative të OBKD-së, përgatit propozimet për ndryshime, plotësime, saktësime të Statutit, kujdeset për ligjshmërinë e vendimeve të organeve të OBKD-së.

RINIA DHE GRUAJA E ORGANIZATËS BALLI KOMBËTAR DEMOKRAT

Neni 49

Forumi rinor dhe forumi i gruas i Organizatës Balli Kombëtar Demokrat janë pjesë integrale e saj. Ato në planin organizativ janë të përfshira në strukturat e OBKD-së. Për këtë çështje në strukturat e Organizatës krijohen departamentet përkatëse.

Forumi rinor dhe forumi i gruas i OBKD-së përfaqësohet në të gjitha organet drejtuese lokale ose qëndrore.

DEPUTETËT DHE PËRFAQËSUESIT NE PUSHTETIN LOKAL

Neni 50

Kryetari i grupit parlamentar të OBKD-së është me të drejta të plota anëtar i kryesisë së Organizatës.

OBKD-ja bën politikën e vet në organet e pushtetit shtetëror përmes përfaqësuesve të vet të zgjedhur në këto organe. Deputetët e OBKD-së të zgjedhur në parlament përbëjnë grupin parlamentar dhe janë anëtarë të Këshillit Kombëtar. Grupi parlamentar është i detyruar të respektojë politikën e Organizatës dhe të zbatojë vendimet drejtuese të saj.

Kryetari i OBKD-së është kryetar i grupit parlamentar të OBKD-së.

BASHKËPUNIMI ME PARTITE, SHOQATAT DHE FORUMET

Neni 51

OBKD me vendim të Këshillit Kombëtar bën pjesë në aleancat dy ose më shumë palëshe të forcave të tjera politike të djathtë dhe të qëndresës së djathtë.

SHTYPI DHE MJETET E INFORMACIONIT PUBLIK TË OBKD

Neni 52

Organet e shtypit dhe mjetet e tjera të informimit publik të OBKD-së mbështesin punën e tyre mbi normat e Statutit dhe në Programin e OBKD-së. Ato ruajnë të drejtën për të qenë të lira në dhënien e informacioneve.

MJETET FINANCIARE TË ORGANIZATËS

Neni 53

Të ardhurat financiare të OBKD-së përbëhen nga:

- **Kuotat(Antarsia) e OBKD-së**
- **Buxheti i shtetit, sipas ligjit për financimin e partive politike**
- **Të ardhurat nga veprimtaria botuese e OBKD-së**
- **Nga ndihmat e dhuruara nga anëtarët dhe simpatizantët e OBKD-së**
- **Të ardhurat nga veprimtaria me pagesë**
- **Të ardhura të tjera në përputhje me ligjet e shtetit, kontribute vullnetare, të qytetarëve, të ndërmarreve etj.**

Neni 54

Rezultatet financiare dhe buxheti vjetor i OBKD-së shqyrtohen dhe miratohen në Këshillin Kombëtar.

Neni 55

Për kontrollin ekonomik dhe financiar është ngarkuar Komisioni i Kontrollit dhe i respektimit të Statutit në degë dhe në qendër.

Neni 56

Anëtarët e Komisionit të Kontrollit dhe të respektimit të Statutit nuk mund të jenë në asnjë pozicion tjetër në organet drejtuese të OBKD-së. Asnjëri nuk mund të jetë anëtar i përhershëm i Komisionit të Kontrollit dhe të respektimit të Statutit.

Neni 57

Organizata dhe fondet financiare të saj janë të çliruara nga taksat.

DISPOZITA TË NDRYSHME DHE TË FUNDIT

Neni 58

Programi dhe Statuti i Organizatës janë të hapur për çdo ndryshim pozitiv që e kërkon nevoja në rritjen dhe forcimin e Organizatës.

Neni 59

"Organizata Balli Kombëtar Demokrat" është person juridik në Republikën e Kosovës.

Neni 60

Veprimtaria e OBKD-së mund të ndërpritet kur në referendumin e organizuar me këtë rast, vendoset me shumicën e votave për mbylljen e veprimtarisë politike.

Neni 61

Ky Statut hyn në fuqi menjëherë pas votimit në Kongresin e Organizatës.